



Në bazë të nenit 40.2 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.27.09.2018 pas një debati të zhvilluar me 17 vota "për", 5 vota "kundër" dhe 1 "abstenim", bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2019

I.

Aprovohet buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2019-sipas Kufijve final të MF-it.

II.

Të hyrat dhe shpenzimet e përgjithëshme buxhetore të paraqitura në pjesën tabelare të cilat janë pjesë përbërse e këtij Vendimi, autorizohen për vitin fiskal 2019, për periudhën prej 01 Janar deri me 31 Dhjetor dhe ate:

- Paga dhe medijtje -5,399,876,00€ (5,389,376.00 nga grantet dhe 10,500.00 nga THV)
- Mallra dhe shërbime-1,230,474.00€ (980,947.00 nga grantet dhe 249,527.00 nga THV)
- Shpenzime komunale -155,500.00€ (155,500.00€ nga grantet)
- Subvencione dhe trans -90,000.00€ (49,000.00 nga grantet dhe 41,000.00 nga THV)
- Shpenzime kapitale-2.075,506.00€(1,706,130.00 nga grantet dhe 369,376.00 nga THV)
- **TOTAL BUXHETI – 8,951,356.00€(8,280,953.00 nga grantet dhe 670,403.00 nga të hyrat vetanake)**

III.

Të hyrat vetanake të pashpenzuara nga viti 2018 autorizohen të shpenzohen në vitin 2019, për destinimet për të cilat është bërë zotimi i tyre.

IV.

Saldoja e pashpenzuar nga viti buxhetor 2018 autorizohet të shpenzohet në vitin 2019.

V.

Nuk mund të bëhen kurrfarë shpenzimesh apo detyrime financiare të cilat bijnë ndesh me këtë vendim.

VI.

Mjetet e destinuar për paga dhe shtesa nuk mund të tejkalohen, e gjithashtu as numri i punëtorëve të paraparë nga BKK.

VII.

Pjesa tabelare e paraqitur në ANEXIN PCF-1, PCF-2, PCF-3 dhe PCF-4 të të gjitha linjave buxhetore janë pjesë përbërse të këtij Vendimi.

VIII.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

IX.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti i buxheteve Komunale dhe organet kompetente të Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-2

Deçan,dt.27.09.2018



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal i Deçanit, në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.27.09.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRPUNIMIN, NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLOREVE TË KOMUNËS SË DEÇANIT

I.

Formohet komisioni për përpunimin, ndryshimin dhe plotësimin e Rregulloreve të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Lirije Zukaj (AAK),
2. Besjana Ukëhaxhaj(AAK),
3. Uran Tolaj(LDK),
4. Kestrim Avdimetaj (PDK),
5. Ajne Ibërhysaj nga Ekzekutivi

Mbledhja e parë e Komisionit ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Komisioni e zgjedhë Kryesuesin nga radhët e veta.

II.

Detyrë e Komisionit është që të bëjë shqyrtimin, përpunimin, ndryshimin dhe plotësimin e të gjitha rregulloreve komunale dhe harmonizimin e tyre me Ligjin për vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe të përgaditë elaboratin për Themelimin e Teatrit të qytetit të Deçanit sipas dispozitave të Ligjit nr.04/L-106 Ligji për Teatrot.

Pas shqyrtimit dhe harmonizimit të Rregulloreve Komunale me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komisioni i dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit, ndërsa pas përgaditjes së elaboratit për themelim të Teatrit të qytetit, Komisioni materialin ia dorëzon Kryetarit të Komunës.

III.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryetari dhe Arhivi.

01.Nr.IX-7


Deçan,dt.27.09.2018

KUVENDI KOMUNAL I DEÇANIT

HYRËSE-KALAZMA-INGOINIB REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DECANI • DEÇANI MUNICIPALITY	
Nr. Prot: 09	Nr. Prot: 31455
K. Komunej	
01	Data: 04.10.18
	Satim: 20



Kryesuesi:
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.09.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

I.

Ndryshohet dhe plotësohet pika nr.I.1 e Vendimit të dt. 31.01.2018, për formimin e Komitetit të Komuniteteve, pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Hedije Kuçi, emrohet anëtare e Komitetit të Komuniteteve në vend të Hurka Halilaj, nga i njëjti komunitet- përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak .

II.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- E emruara në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-8

Deçan,dt.27.09.2018

DALËSE-AZLAZNA-OUTSIDING	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DECANI MUNICIPALITY	
Nr. i Org. Org. Jeshme Org. Udh.	K. Komunale
Nr. i Isqove: Dr. Stranica: No Pages	01
Nr. Prot: Dr. Prot: Prot. No	31654
Data: Detyrë: Dette:	04.10.18
DECAN DECANI	



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 4 të Ligjit nr.04/L-106 Ligji për Teatrot, sipas Rregullores Nr.04/2015 për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit të Teatrove Kombëtare dhe të Teatrove të Qyteteve, duke u bazuar në nenin 17 pika (s) dhe nenit 40 pika (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në harmoni me nenin 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.09.2018, bie këtë:

V E N D I M

Mbi Inicimin e Procedurave për Themelimin e Teatrit Profesionist të Qytetit të Deçanit “Skender Tafaj” në Deçan

I

Me këtë vendim Inicohet procedura për themelimin e Teatrit Profesionist i Qytetit të Deçanit “Skender Tafaj” në Deçan, i cili do të organizohet sipas Ligjit mbi Teatrot Nr. 04/L-106 dhe Rregullores Nr.04/2015 për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit të Teatrove Kombëtare dhe të Teatrove të Qyteteve.

II

Në bazë të këtij Vendimi do të bëhet edhe përgaditja e Elaboratit për zhvillimin e procedurave për themelimin e Teatrit Profesionist i Qytetit të Deçanit “Skender Tafaj” në Deçan, sipas dispozitave të nenit 11 të Ligjit mbi Teatrot dhe Kushteve dhe Kriteret të përcaktuara me Rregulloren Nr.04/2015 për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit të Teatrove Kombëtare dhe të Teatrove të Qyteteve.

III

Kuvendi i Komunës së Deçanit me vendim të veçantë formon Komisionin si bartës të përgaditjes së Elaboratit për zhvillimin e procedurave për themelimin e Teatrit Profesionist të Qytetit të Deçanit “Skender Tafaj” në Deçan.

IV.

Për implemimentimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.IX-6

Deçan,dt.27.09.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj

HYRJE-KULZHA-BUDGJE	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DEÇANI MUNICIPALITY	
Nr. Prot. 31456	Br. Prot. 31456
Forma: K.K. Deçan AS	Prot. No. 31456
Nr. i faqes	Data